

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT  
SH. A.

KOMPANIA E UJËSJELLËSIT RAJONAL  
**HIDRODRINI**

SH. A. - PEJË,  
Nr. 660 Data 29.12.2021

**HIDRODRINI**

Zyret qendrore  
Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156 30000 Pejë  
Telefoni: 039 / 432 355  
[www.hidrodrini.com](http://www.hidrodrini.com)

Bazuar në Ligjin Nr.03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin 05/L-009, nenin 42 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, Ligjin Nr. 04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe nenin 7 paragrafi 2 të Statutit të KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë, Bordi i Drejtorëve i KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 28.12.2021, miratoi këtë :

## **RREGULLORE PËR SIGURINË DHE MBROJTJEN NË PUNË TË PUNËTORËVE TË KRU "HIDRODRINI" Sh. A. PEJË**

### **Dispozitat e përgjithëshme**

#### **Neni 1**

1.1 Qëllimi i kësaj Rregullore është që të përcaktohen masat për përmirësimin e shkallës së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarëve në punë.

#### **Neni 2**

2.1 Kjo Rregullore përmban parimet e përgjithëshme për parandalimin e rreziqeve profesionale, eliminimin e faktorëve të rrezikut, aksidenteve, informimit, konsultimit, pjesëmarrjes së balancuar në përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë, trajnimin e të punësuarëve, përfaqësuesve të tyre dhe udhëzimeve të përgjithëshme për zbatimin e këtyre parimeve .

### **Fushëveprimi**

#### **Neni 3**

3.1 Me qëllim të të mbrojtjes dhe sigurimit të shëndetit në punë të punëtorëve të KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë, nga lëndimet në punë, sëmundjet profesionale dhe evitimin e shkaqeve të dëmtimit të shëndetit dhe lëndimeve në punë si dhe krijimit të kushteve sa më të mira të punës në Kompani zbatohen dispozitat e Ligjit Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, të kësaj Rregullore si dhe aktet tjera të përgjithëshme.

3.2 Procesi i punës duhet të organizohet në atë mënyrë që secili punëtor të punoj pa rrezik për shëndetin dhe jetën e tij dhe punëtorëve të tjerë.

3.3 Organizimi i procesit të punës me të cilin garantohet siguria e punëtorëve në punë është detyrë themelore e drejtuesve, udhëheqësve të Njësive Operative dhe përgjegjësve tjerë të Kompanisë.

#### **Neni 4**

4.1 Këto dispozita zbatohen edhe për praktikantët, nxënësit dhe studentët gjatë kryerjes së punës praktike në Kompani.

### **Detyrimet e Kompanisë**

#### **Neni 5**

5.1 Parimet e Përgjithëshme të KRU "Hidrodrini" Sh. A. për lëmin e sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve në punë janë:

- a. Krijimi i kushteve për punë të sigurtë dhe të shëndetëshme për punëtorët në të gjitha aspektet e punës.
- b. Të mbuloj të gjitha shpenzimet për shërimin e të punësuarit që ka pësuar lëndim në punë apo sëmundje profesionale nëse nuk janë të siguruar në ndonjë Kompani të sigurimeve në pikëpamje shëndetësore.
- c. Që të bëj vlerësimin e hollësishëm mbi rreziqet për secilin vend të punës.
- d. Trajtim të barabartë në marrjen e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë për të gjithë të punësuarit.
- e. Të ndër marrë masat për siguri dhe shëndet në punë, masat për parandalimin e rreziqeve profesionale, trajnimin e të punësuarëve për punë më të sigurt, udhëzimet e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve të punës, instrumenteve, pajisjeve dhe veglave të punës, si dhe masat për organizimin dhe mbarvajtjen e procesit të punës
- f. Që të veproj në vazhdimësi në sigurimin dhe përmirësimin e kushteve të punës për të ngritur nivelin e sigurisë dhe shëndetit në punë duke i ndryshuar dhe plotësuar masat e ndërmarra më parë varësisht prej rrethanave të cilat krijohen me ndryshimet e proceseve teknike-teknologjike .

## **Masat parandaluese**

### **Neni 6**

6.1 Kompania është e detyruar të zbatoj masat parandaluese, bazuar në parimet e përgjithëshme të parandalimit si:

- a) Parandalimi dhe shmangia e rreziqeve
- b) Vlerësimin e rreziqeve të pashmangëshme
- c) Luftimin e rrezikut prej fillimit ose burimit
- d) Tejkalimin e shkaqeve të rrezikut
- e) Adaptimin e punës ndaj individit, veçmas në lidhje me karakteristikat e vendit të punës dhe ambientit të punës
- f) Zgjedhjen e pajisjeve, metodave të punës dhe të procesit të punës, për të lehtësuar punën e njëtrajtëshme dhe për t'i reduktuar efektet e saj në shëndet
- g) Përshtatjen me progresin teknik
- h) Zëvendësimin e kushteve të rrezikshme me kushte të parrezikshme ose më pak të rrezikshme
- i) Zhvillimin e një politike parandaluese gjithpërfshirëse që ka të bëjë me teknologjinë, organizimin e punës, kushtet e punës, marrëdhënjet shoqërore dhe ndikimin e faktorëve që lidhen me mjedisin e punës
- j) Dhënjen e përparësisë së sigurisë kolektive në raport me sigurinë individuale.
- k) Sigurimin e udhëzimeve të përshtatshme për punë të sigurt dhe të shëndetëshme për të punësuarin dhe vendosjen e tyre në vendet e dukshme dhe gjuhën që e kupton ai/ajo.

6.2. Kompania duke marrë parasysh natyrën e aktiviteteteve të punës bënë vlerësimin e rrezikshmërisë të vendeve të punës, substancave apo preparateve kimike që përdoren.

6.3 Pas vlerësimit të bërë nga paragrafi 2 i këtij neni është e domosdoshme që të:

- a) Siguroj një nivel më të mirë të sigurisë dhe shëndetit të të punësuarëve në punë, duke eliminuar faktorët e rrezikut, zvogëluar ndikimin e substancave të dëmshme kimike, përmirësuar pajisjet e punës.

- b) Integroj dhe zbatoj masat parandaluese që dalin prej vlerësimit të rrezikut në të gjitha aktivitetet e subjektit punues dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë

6.4 Punëdhënësi kur ia beson detyrat e punës një të punësuarit obligohet që :

- a. të marrë parasysh aftësitë e tij /saj për kryerjen e atyre detyrave të punës.
- b. t'i informoj dhe trajnoj të punësuarit për punë të sigurt me rastin e zëvendësimit të teknologjisë ekzistuese me teknologji të reja
- c. që të ndërmarrë masat e duhura për sigurinë dhe shëndetin në punë duke siguruar udhëzime të përshtatshme për punë, për të punësuarit në vende të punës me rrezikshmëri të lartë dhe në këto vende të punës mund të angazhohet vetëm të punësuarit e trajnuar dhe të kualifikuar për vendet përkatëse.

#### Neni 7

##### **Organizimi i kryerjes së punëve të sigurisë në punë**

7.1 Punëdhënësi është i obliguar që në harmoni me ligjin, t'a punësojë një punëtor i cili do t'i kryente punët dhe detyrat e punës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë të punëtorëve . Zyrtares për siguri dhe mbrojtje të shëndetit në punë ka për detyrë pos tjerash me i vizituar të gjitha NJO dhe vendet e punës dhe të kontrollojë aplikimin e masave të sigurisë në punë. Në bazë të këtij kontrolli ai duhet të bëjë raporte dhe lidhur me to, t'i informoj personat përgjegjës. Në raportet e tij, ai posaqërisht do të theksojë sidomos mos zbatimin e masave të sigurisë në punë nga ana e punëtorëve të caktuar.

7.3 I punësuarit i ngarkuar sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk mund të çenohet për shkak të aktiviteteve të tij në lidhje me sigurinë dhe parandalimin e rreziqeve në punë, as nga punëdhënësi as nga të punësuarit tjerë.

7.4 Për të punësuarin e ngarkuar, i cili ushtron aktivitete nga lëmia e shëndetit dhe sigurisë në punë, punëdhënësi duhet të sigurojë trajnime dhe mjete të nevojshme për punë.

#### Neni 8

##### **Ndihma e parë, fikja e zjarreve, evakuimi i të punësuarëve, rreziqet serioze dhe të mundëshme**

8.1 Punëdhënësi është i detyruar :

- a. të ndërmarrë masat e nevojshme për ndihmën e parë, fikjen e zjarrit dhe evakuimin e të punësuarëve të përshtatura sipas natyrës së aktiviteteve dhe madhësisë së subjekteve punuese.
- b. të organizoj dhe t'i ofroj ndihmën e parë të punësuarëve në rast të lëndimit në punë ose sëmundjeve të papritura dhe të sigurojë përcjelljen e tyre për trajtim mjekësor.
- c. të trajnon personat që do të kryejnë evakuimin, shpëtimin fikjen e zjarrit dhe dhënjën e ndihmës së parë.
- d. përmes personave të trajnuar kryen evakuimin, shpëtimin, fikjen e zjarrit dhe dhënjën e ndihmës së parë, për të punësuarit në subjektin punues.
- e. harton një plan dhe skemë për evakuimin dhe shpëtimin në situatë emergjente të cilin ia bënë të ditur të gjithë të punësuarëve, si dhe kryen ushtrime praktike të paktën një herë në dy (2) vjet, në përputhje me këtë Plan.
- f. të mbajë kontakte të nevojshme me shërbimet e jashtme sidomos lidhur me ndihmën e parë, kujdesin emergjent mjekësor, shërbime shpëtimi dhe shërbimin e zjarrëfikësive si dhe drejtorin për emergjencë.

8.2 Punëdhënësi në rast të rrezikut të mundshëm dhe serioz për jetën dhe shëndetin e të punësuarëve, duhet që :

- a) t'i informoj të gjithë të punësuarit të cilët janë apo mund të jenë të ekspozuar rreziqeve serioze dhe të mundshme, në mënyrë që t'a parandaloj ose zvogëloj rreziqet për jetën dhe shëndetin.
- b) Të marrë masa dhe të jap udhëzime për t'iu mundësuar të punësuarve që në rast të rreziqeve serioze dhe të mundshme në vendin e punës, t'a ndërpresin punën dhe menjëherë t'a braktisin atë vend të punës dhe të vendosen në një vend të sigurtë.
- c) Të përmbahet nga kërkesa drejtuar të punësuarve që të vazhdojnë punën në situatë kur ende ka rrezik serioz dhe të mundshëm.
- d) Të angazhoj në punë për evitim të rrezikut dhe normalizimin e procesit të punës, vetëm të punësuarit e kualifikuar, të specializuar dhe të trajnuar për kryerjen e punëve në kushte të veçanta dhe me rrezikshmëri të lartë.
- e) Të organizoj vazhdimin e procesit të punës vetëm pas kalimit të rrezikut, përveç në rastet e jashtëzakonshme dhe objektivist të justifikuara kur ndërprerja e procesit të punës shkakton dëme më të mëdha në njerëz.

8.3 Të punësuarit në rastet kur janë të rrezikuar seriozisht dhe të cilët nuk mund të kontaktojnë menjëherë me personin përgjegjës do të veprojnë sipas aftësive të tyre të fituara me trajnime dhe pajisjeve teknike që kanë në dispozicion, për të shmangur pasojat e një rreziku të tillë.

8.4 Të punësuarit të cilët veprojnë në përputhje me këtë nen nuk do të kenë përgjegjësi për pasojat e mundshme përveç në rastet kur ata veprojnë qëllimisht në kundërshtim me udhëzimet për veprim ose nuk veprojnë fare duke neglizhuar rrezikun.

#### **Neni 9**

**Ndihma e parë në rast të lëndimeve ose fatkeqësive elementare**

9.1 Punëtorëve në rast të lëndimit, helmimit ose të sëmundjes së hovshme ndihmën e parë ua japin punëtorët që kanë provimin e dhënë të ndihmës së parë.

#### **Neni 10**

10.1 Në të gjitha hapsirat e objektit në Kompani, në vendet e dukshme dhe të përdorshme, duhet të jenë të vendosura kutitë me mjetet e nevojshme sanitare për dhënien e ndihmës së parë.

10.2 Në së paku çdo 50 punëtorë, duhet të ekzistojë 1 kuti sanitare.

#### **Neni 11**

11.1 Në kutinë sanitare duhet të jenë të theksuara numrat e telefonave:

- a) Të stacionit shëndetësor
- b) Të ndihmës së shpejt
- c) Të shërbimit të zjarrfikësve
- d) Të inspekcionit të punës
- e) Të policisë
- f) Emrat e personave që janë aftësuar për dhënien e ndihmës së parë
- g) Të Zyrtarit për siguri dhe shëndet në punë

#### **Neni 12**

12.1 Mjetet për dhënien e ndihmës së parë, në kutinë sanitare duhet të përtrihen rregullisht dhe të mirëmbahen, që të jenë çdo herë në gjendje përdorimi, sipas rregulloreve në fuqi.

12.2 Udhëheqja me mjetet në kutitë sanitare i lejohe vetëm zyrtarit për mbrojtje dhe siguri në punë, si dhe personit të ngarkuar e të aftësuar për dhënien e ndihmës së parë.

### **Neni 13**

13.1 Në rast të fatkeqësisë elementare, eksplozimit, zjarrit ose fatkeqësie tjetër, punëdhënësi është i obliguar të organizoj masa për evakuimin e punëtorëve dhe personave tjerë të rrezikuar.

13.2 Me qëllim të shpëtimit dhe evakuimit me kohë, punëdhënësi harton planet e evakuimit dhe shpëtimit të punëtorëve.

### **Neni 14**

**Detyrimet e punëdhënësit për caktimin e masave për parandalimin e aksidenteve në punë dhe të sëmundjeve profesionale.**

14.1 Punëdhënësi për caktimin e masave për të parandaluar aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale është e detyruar që:

- a. Të miratoj fazën e kërkimit dhe hartimit të Planit për përdorimin e pajisjeve të punës në përputhje me dispozitat e Rregullores dhe ligjeve që çojnë në zvogëlimin dhe shmangien e rreziqeve, aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale.
- b. Të siguroj informimin e çdo të punësuarit përpara fillimit të punës për rreziqet ndaj të cilave ai mund të ekspozohet në vendin e tij/saj të punës dhe masat e nevojshme parandaluese dhe mbrojtëse
- c. siguroj që të punësuarit të jenë të pajisur me kualifikimet e nevojshme profesionale
- d. merrë në punë të punësuarit në bazë të ekzaminimit mjekësor të tij në varësi prej vendit të punës
- e. të lejoj përfaqësuesin e të punësuarëve me kërkesën e këtij të fundit, të marrë pjesë gjatë vizitës së inspektimit si dhe në rastet e hetimit të ngjarjeve
- f. të lejoj të punësuarin të marrë pjesë në inspektimin dhe hetimin e ngjarjeve me kërkesën e inspektorit të punës
- g. të ruaj të gjitha provat në vend ngjarje ku ka ndodh aksidenti me pasoj vdekje qoftë ky kolektiv, me përjashtim të rasteve kur ruajtja e atyre provave në vend ngjarje mund të shkaktoj një aksident tjetër
- h. siguroj një numër të mjaftueshëm të aparateve për fikjen e zjarrit dhe të njëjtat të jenë me mbushje adekuate sipas llojit të shkaktarit të zjarrit
- i. mbaj në gjendje të rregullt aparatet për fikjen e zjarrit dhe t'i rimbush në afate ( 6 muaj) të caktuara të cilat shënohen në etiketën e vendosur në aparat.
- j. vendos në vende të përshtatshme aparatet për fikjen e zjarrit
- k. instaloj hidrant në subjektet punuese ku ka rrezik të shtuar për shpërthimin e zjarrit dhe ku konsiderohet që aparatet për fikjen e zjarrit nuk janë të mjaftueshme.
- l. vendos hidrantët në vende të dukshme, të përshtatshme të cilët duhet të jenë në gjendje të rregullt, për përdorim në çdo kohë.
- m. të shënoj qartë ndalimin e pirjes së duhanit në vendet e punës dhe në vendet publike
- n. furnizoj të punësuarit në mënyrë të detyrueshme me mjete mbrojtëse individuale, të siguroj mirëmbajtjen e tyre dhe të respektoj afatet e skadimit të përdorimit të tyre .

### **Neni 15**

**Përdorimi i mjeteve të punës dhe pajisjeve mbrojtëse individuale gjatë procesit të punës**

15.1 Punëdhënësi është i obliguar që mjetet e punës t'i mbaj në gjendje të rregullt, t'a kontrolloj rregullsinë dhe sigurinë e tyre me kontrollera të herë pas herëshme, në afate të përcaktuara me udhëzimin e prodhuesit, dispozitat dhe standardet teknike.

15.2 Nëse me udhëzimin e prodhuesit nuk janë parashikuar afate të tjera, punëdhënësi është i obliguar që mjetet e punës t'i kontrolloj, testoj dhe provoj:

- a) Para përdorimit të parë
- b) Pas rekonstruktimit, pas avarisë dhe
- c) Pas zhvendosjes nga njëri vend në vendin tjetër

15.3 Punëdhënësi duhet të siguroj që mjetet e punës dhe pajisjet individuale, mbrojtëse të jenë në gjendje të mirë dhe të rregullt në çdo kohë.

#### Neni 16

##### Objektet / ndërtesat

16.1 Për çdo objekt / ndërtesë të destinuar për punë, punëdhënësi duhet të siguroj:

- a. Që secila ndërtesë t'i ketë daljet emergjente.
- b. Planin për evakuim, në mënyrë që të punësuarit të evakohen nga ndërtesa në rastin e ngjarjeve të papritura prej të cilave rrezikohet jeta dhe shëndeti i tyre
- c. Që rrugët dhe daljet emergjente të jenë të shënuara qartë me shenja adekuate, të cilat do të vendosen në vende të dukshme dhe në përputhje me rregullat.
- d. Që rrugët dhe daljet emergjente të jenë të lira, pa pengesa dhe të cilat të dërgojnë direkt jashtë zonës së rrezikshme apo në një zone të sigurt.
- e. Hapësirën për dhënjen e ndihmës së parë dhe pajisjet e nevojshme
- f. Hapësirat ndihmëse (dhoma për ushqim, dhoma e veshjeve/garderoba, toaletet ndaras për femëra dhe meshkuj)

##### Mjetet e punës

#### Neni 17

17.1 Punëdhënësi furnizon të punësuarit me mjete mbrojtëse të cilat janë paraparë për mbrojtjen kundër rreziqeve në punë. Punëdhënësi do t'i bartë shpenzimet dhe do të bëj zëvendësimin e mjeteve personale mbrojtëse në intervale të rregullta kohore (sipas normativave) si dhe atëherë kur është e domosdoshme.

#### Neni 18

##### Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës

18.1 Punëdhënësi është i obliguar të bëj vlerësimin e rrezikshmërisë në vendet e punës, me qëllim të parandalimit të rrezikut, përfshirë edhe ekspozimin e të punësuarëve nga elementet e dëmshme dhe të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë në punë gjatë procesit të punës.

18.2 Punëdhënësi pas procesit të vlerësimit të rrezikshmërisë është i detyruar të hartoj dokumentin e vlerësimit të rrezikut dhe të ndërmarrë masat mbrojtëse të domosdoshme për sigurinë dhe shëndetin në punë të të punësuarëve.

18.3 Punëdhënësi është i detyruar të mbaj evidencën për lëndime në punë, sëmundjet profesionale dhe të pajisë të lënduarin me formularin për lëndim në vend të punës.

18.4 Formularin për lëndim e plotëson personi i autorizuar i sigurisë dhe mbrojtjes në punë në afate prej 24 ore e më larg në afate prej 48 ore për raste vikendi dhe festa. Shkakun e aksidentit e përcakton Komisioni Profesional i formuar nga Kryeshefi Ekzekutiv. Në rast se nuk është formuar Komisioni Profesional, shkaku e aksidentit e konstaton personi i autorizuar i sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Shkaku i konstatuar i aksidentit shenohet në formularin për

lëndim në punë. Personi i autorizuar për konstatimin e shkakut të lëndimit në formularin për lëndim domosdo konstaton se aksidenti ka ndodhë me fajin e punëmarresit duke mos vepruar sipas përshkrimit të vendit të punës apo nga lëshimet eventuale të punedhënesit. Formularin e lëndimit në punë e nënshkruajnë :

- a) Zyrtari i autorizuar i sigurisë në punë
- b) Udhëheqësi i sektorit/departamentit dhe
- c) Kryeshefi Ekzekutiv.

18.5 Formulari i plotësuar dhe i nënshkruar dërgohet te institucioni shëndetsor dhe plotësohet nga mjeku përkatës. Konstatimin dhe vlerësimin e shkallës së paaftësisë – invaliditetit duhet ta jap Komisioni mjekësor.

## **Neni 19**

### **Informimi i të punësuarëve**

19.1 Kompania duhet të marrë masa adekuate që të punësuarit të marrin të gjitha informatatë e nevojshme lidhur me:

- a. çdo rrezik që mund të paraqitet në vendet e punës, masat mbrojtëse dhe parandaluese si dhe aktivitetet që i ndërmerren nga ana e tij për eliminimin e këtyre rreziqeve
- b. informimin e të punësuarëve dhe përfaqësuesve të tyre për ndihmën e parë, masat në rast zjarri, evakuimin si dhe përgjegjësit e veçanta të secilit për marrjen e këtyre masave
- c. vlerësimin e rrezikut si dhe masat e ndërmarra për të siguruar shëndetin dhe sigurinë në punë për të punësuarit

## **Neni 20**

### **Trajnimi i të punësuarëve**

20.1 Punëdhënësi obligohet që të përkujdeset që secili i punësuar të trajnohet nga siguria dhe shëndeti në punë për vendin e tij të punës :

- a. para ose pas themelimit të marrëdhënies së punës
- b. në rast të transferimit apo ndërrimit të vendit të punës
- c. në rast të paraqitjes së pajisjeve të reja apo ndërrimit të pajisjeve të punës
- d. në rast të përdorimit të teknologjisë së re
- e. kohë pas kohe nëse është e domosdoshme

20.2 Trajnimi i referuar në paragrafin 1 i këtij neni organizohet gjatë orarit të punës.

## **Neni 21**

### **Detyrimet e të punësuarit**

21.1 Çdo i punësuar ka përgjegjësi të përkujdeset për sigurinë dhe shëndetin e vet dhe të personave tjerë në punë në përputhje me trajnimet dhe udhëzimet që i janë dhënë nga punëdhënësi.

21.2 Në përputhje me trajnimin, udhëzimet e dhëna nga punëdhënësi, i punësuarit është i detyruar që të :

- a) përdorë me korrektësi makinerit, aparataturat, veglat, pajisjet e transportit, mjetet tjera për punë dhe të veprojnë me kujdes me substancat e rrezikshme
- b) përdorë me korrektësi pajisjet mbrojtëse individuale të vëna në dispozicionin e tyre dhe pas përdorimit t'i rikthejnë ato në vendin që është planifikuar për ruajtjen e tyre të sigurt

- c) të mos nxjerrë jashtë shërbimit, të ndryshoj apo të zhvendos arbitrarisht mekanizmat e sigurisë të montuara në makineri, aparatura, vegla, impiante, ndërtesa dhe t'i përdor si duhet këta mekanizma .
- d) njoftoj me shkrim punëdhënësin, personin e ngarkuar për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përfaqësuesit e të punësuarëve, për çdo situatë pune për të cilën kanë një motiv të arësyeshëm për t'a vlerësuar si rast që paraqet një rrezik të rëndë dhe të menjëhershëm për sigurinë dhe shëndetin në punë.
- e) respektoj të gjitha detyrimet e përcaktuara prej punëdhënësit nga fusha e sigurisë dhe shëndetit ose në të kundërtën do të jetë përgjegjës për dëmin apo aksidentin e shkaktuar.

21.3 I punësuar mund të refuzoj urdhëresën për punë nëse e ka lajmëruar punëdhënësin, personin për çështje të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përfaqësuesin e të punësuarëve për rrezikun që i kanoset atij/asaj nëse punon në ato kushte të punës, derisa nuk evitohet rreziku dhe nuk krijohen kushtet normale për punë

## Neni 22

### **Përcaktimi i shkeljes së obligimeve në punë lidhur me sigurinë në punë**

22.1 Shkeljet e detyrave të punës nga lëmi i mbrojtjes në punë duke marrë për bazë peshën dhe pasojat mund të jenë të lehta dhe të rënda.

22.2 Nga lëmia e mbrojtjes në punë si **shkelje të lehta** të obligimeve në punë konsiderohen:

- a) qëndrimi i pandërgjegjshëm ndaj mjeteve të besuara dhe në rastet kur pasoja e dëmit nuk është shkaktuar;
- b) shkaktimi i dëmit ndaj Kompanisë në shkallë më të vogël;
- c) mos lajmërimi i dëmit të cilin e ka shkaktuar punëtori tjetër;
- d) mos dhënia e këshillave profesionale nga ana e punëtorit përgjegjës ndaj punëtorëve tjerë;
- e) mbajtja e mjeteve të punës në gjendje jo të rregullt (sistematizuar, arkivuar etj);
- f) lajmërimi me vonesë i prishjeve në pajisjet, mjetet e punës dhe mjetet mbrojtëse;

22.3 Nga lëmia e sigurisë në punë si **shkelje të rënda** të obligimeve në punë konsiderohen :

- a) shkelja e dispozitave të mbrojtjes nga zjarri, eksplozimeve, fatkeqësive elementare dhe materialeve të rrezikshme;
- b) disponimi dhe shfrytëzimi i paautorizuar dhe kundërligjor i mjeteve të kompanisë;
- c) mosndërmarrja e veprimeve të mbrojtjes të punëtorëve në punë dhe e mjeteve të punës;
- d) keqpërdorimi, tjetërsimi ose vjedhja e mjeteve të kompanisë
- e) fshehja e dëmtimeve të mjeteve të punës nga punëtori i cili menaxhon me ato mjete ose e bënë kontrollin teknik të tyre;
- f) kryerja e punëve private në Kompani gjatë kohës së punës me mjetet e veta ose me mjetet e Kompanisë;
- g) mosndërmarrja e veprimeve të sigurimit të punëtorëve në punë dhe e mjeteve të punës;
- h) përdorimi i paautorizuar i mjeteve të kompanisë të besuara punëtorit për kryerjen e detyrave të punës
- i) fshehja e dëmtimeve të mjeteve të punës nga punëtori i cili menaxhon me ato mjete ose e bënë kontrollin teknik të tyre;
- j) Në qoftë se edhe pas vërejtjes punëtori refuzon t'i shfrytëzojë mjetet e sigurisë personale
- k) Në qoftë se nuk merrë pjesë në aftësimin e organizuar për mbrojtjen në punë dhe nuk i nënshtrohet verifikimit të njohurive të fituara



- l) Në qoftë se personit përgjegjës nuk ia paraqet dukurit të cilat mund të shkaktojnë fatkeqësi në punë.
- m) Në qoftë se në punët me rrezik të shtuar edhe përkundër njohurisë se nuk janë siguruar masat e mbrojtjes në punë, vazhdon të punoj dhe për këtë arsye shkaktohen pasoja të rënda për punëtorët dhe pronën
- n) Në qoftë se pa arsye refuzon ekzekutimin e vendimeve udhëzimeve ose urdhërave për mbrojtje dhe siguri në punë të cilat i bien organet kompetente apo personi përgjegjës
- o) Në qoftë se nuk ndërpre punën derisa ndodhet nën ndikimin e alkoolit ose narkotikëve, pasi që udhëheqësi t'i ketë urdhëruar ndërprerjen e punës.
- p) Në qoftë se në çfardo mënyre nuk i kryen obligimet e parapara me këtë Rregullore, për ç'arsye shkakton pasoja të rënda për shëndetin ose jetën e punëtorëve ose Kompania pëson dëm material

### **Neni 23**

23.1 Procedura për vërtetimin e shkeljeve në punë nga mbrojtja në punë si dhe shqiptimi i masave disiplinore bëhet sipas dispozitave ligjore dhe Rregullores për Përgjegjësin disiplinore dhe materiale të punëtorëve të KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë

### **Neni 24**

#### **Masat kundër punëtorit për shkak të mos përmbajtjes së obligimeve të sigurisë në punë**

24.1 Punëtori përgjegjës ka të drejtë dhe obligim të ndaloj punën punëtorit në këto raste:

- a. në qoftë se nuk respekton dispozitat nga siguria në punë dhe kryen punë kundër masave të sigurisë, për ç'arsye mund të lëndohet personalisht ai apo rrezikon të lëndohen punëtorët tjerë
- b. nëse kryen punë pa përdorimin e mjeteve të sigurisë që I ka në posedim, por nuk I shfrytëzon ato.
- c. nëse refuzon të veproj sipas udhëzimeve për punë të sigurt që I jep udhëheqësi I drejtëpërdrejt.
- d. nëse konstatohet se ka ndërprerë, hequr apo asgjësuar mjetin mbrojtës ose pajisjen dhe punon pa të njëjtat.
- e. kur punëtori drejtëpërdrejtë përgjegjës konstaton se punëtori ka ardh në gjendje të dehur ose nën ndikimin e narkotikëve ose është dehur gjatë orarit të punës

### **Neni 25**

25.1 Kundër punëtorit që ka bërë shkelje bëhet fletëparaqitja për shkelje të obligimit në punë, ndërsa punëtori I autorizuar fillon procedurën disiplinore në harmoni me dispozitat e Rregullores për përgjegjësin disiplinore dhe materiale të punëtorit.

### **Neni 26**

#### **Personat përgjegjës**

26.1 Drejtori dhe personat tjerë përgjegjës bëjnë shkelje të rënda të detyrave të punës nga lëmi I mbrojtjes në punë në qoftë se për shkak të mos kryerjes së obligimeve që janë paraparë për të gjithë punëtorët ose vendet e punës, shkaktohet lëndim i rëndë në punë ose vdekja e punëtorit .

## Neni 27

### Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësia e personave përgjegjës Kryeshefi Ekzekutiv

27.1 Kryeshefi Ekzekutiv ka të drejtë dhe obligim që :

- a. përmes menaxherave të Njësive Operative dhe udhëheqësve të sektorëve të organizoj dhe siguroj zbatimin e dispozitave ligjore për sigurinë në punë dhe dispozitave të kësaj Rregullore
- b. të siguroj mjete financiare për blerjen e mjeteve dhe të pajisjeve për sigurinë në punë.
- c. të siguroj zbatimin e vendimeve të Bordit të Drejtorëve nga lëmia e sigurisë në punë.
- d. me ndihmën e zyrtarit për siguri dhe mbrojtje në punë të punoj në drejtim të avansimit të masave dhe mekanizmave të sigurisë në punë.

## Neni 28

### Udhëheqësi i Njesisë Operative

28.1 Udhëheqësi i Njesisë Operative është përgjegjës për zbatimin dhe aplikimin e masave të sigurisë në punë të punëtorëve dhe është i obliguar që:

- a. të siguroj kontrollimin periodik të mjeteve të punës .
- b. të krijoj siguri në punë për vendet e punës ku kanoset rreziku për shëndetin dhe jetën e punëtorëve.
- c. të propozoj masa për siguri në punë për punëtorët e Njesisë së vet dhe të kujdeset për zbatimin e tyre.
- d. të parashtoj fletëparaqitje disiplinore kundër punëtorëve të cilët nuk i aplikojnë dispozitat e sigurisë në punë

## Neni 29

### Shefi i Shërbimit

29.1 Për zbatimin e dispozitave ligjore nga siguria në punë dhe dispozitave të kësaj Rregullore, janë përgjegjës edhe shefat dhe udhëheqësit e ndërrimeve, secili nga fushë veprimtaria e vet.

29.2 Personat përgjegjës nga paragrafi 1 në zbatimin korrekt të masave të mbrojtjes në punë kanë obligim që:

- a. punëtorin t'a njoftojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë me kushtet dhe burimet e rrezikut dhe ndikimit të dëmshëm të vendit të punës .
- b. punëtorin t'a aftësojnë për mënyrën e përdorimit dhe dedikimin e mjeteve përkatëse dhe të pajisjeve të sigurisë personale si dhe për pasojat eventuale në rast të mos përdorimit të tyre
- c. vazhdimisht dhe pa ndërprerë të mbikëqyrin zbatimin e masave të parapara të sigurisë në punë
- d. të mos i lejoj punëtorit i cili nuk i shfrytëzon mjetet e sigurisë në punë që të punojë në vendin e punës
- e. kohë pas kohe gjatë punës t'a kontrollojnë shkallën e përgatitjes lidhur me sigurinë në punë
- f. menjëherë dhe pa shtyerje, e më së voni brenda 24 orëve të informojnë personin përgjegjës për çdo aksident në punë
- g. t'i paraqesin udhëheqësit përgjegjës mungesën, prishjen ose dukurinë e cila mund të rrezikoj jetën ose shëndetin e punëtorëve.
- h. në rast fatkeqësie t'i ofrojnë ndihmë të lënduarit
- i. t'i bëjnë fletëparaqitje personit përgjegjës për shkelje të detyrave të punës, kundër punëtorëve që nuk u përmbahen masave të parapara të sigurisë në punë e

- j.* posaqërisht kundër atyre që refuzojnë përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë personale.
- k.* me prezencën dhe mbikëqyrjen e tyre, të krijojnë sigurinë e zbatimit të operacioneve të punës, e posaqërisht të punëve të rrezik

### **Neni 30**

#### **Zyrtari për siguri dhe mbrojtje në punë**

30.1 Zyrtari për siguri dhe mbrojtje në punë për realizimin e kushteve të sigurisë në punë ka këto detyra :

- a)* përgatit informata dhe planifikon masat e mbrojtjes në punë
- b)* bashkëpunon me shërbimin juridik për hartimin e akteve nga lëmi i sigurisë në punë.
- c)* merrë pjesë në organizimin e trajnimit të punëtorëve, lidhur me mbrojtjen në punë dhe për këtë mban evidencë.
- d)* merrë pjesë në organizimin e zbatimit të masave të sigurisë në punë dhe jep propozime për sigurimin e kushteve të sigurisë në vendet e punës.
- e)* merrë pjesë në organizimin e kontrollit periodik të mjeteve të punës dhe pajisjeve si dhe të kushteve të punës dhe mban evidence për të njëjtat.
- f)* kryen punë të mbrojtjes preventive (para fillimit të punëve ), informon lidhur me aplikimin e masave të mbrojtjes në punë.
- g)* përmes udhëheqësit të shërbimit të mirëmbajtjes ndikon që të zbatohen masat e sigurisë në punë në procesin e punës të mjeteve të punës, pajisjet dhe veglat e punës dhe për të njëjtat mban evidence
- h)* kujdeset për evidencën e lëndimeve në punë dhe të sëmundjeve që kanë të bëjnë me punën e punëtorëve
- i)* merrë pjesë në kryerjen e detyrave tjera që burojnë nga Ligji, Rregullorja etj.

### **Neni 31**

#### **Plani dhe programi i masave të mbrojtjes në punë**

31.1 Planet dhe programet e masave të mbrojtjes në punë aprovohen sipas procedurës së caktuar për aprovimin e Planeve dhe Programeve të zhvillimit respektivisht të punës.

Plani i mbrojtjes në punë aprovohet për periudhën prej 5 viteve, ndërsa programet e masave të mbrojtjes në punë për periudhën 1 vjeçare.

### **Neni 32**

32.1 Plani i mbrojtjes në punë përmban detyrat për përmirësimin e kushteve të punës dhe masave të mbrojtjes, me të cilat mundësohet puna e sigurtë e punëtorëve, e posaqërisht:

- a.* avancimi teknologjik i veglave dhe pajisjeve për punë dhe ambient të punës
- b.* aftësimi dhe zgjerimi i njohurive të punëtorëve nga lëmi i mbrojtjes në punë
- c.* përmirësimin e kushteve për shëndetin e punëtorëve në punë.
- d.* përmirësimin e sigurisë dhe kushteve të punës, kryerja e të cilave mund të shkaktojë sëmundje dhe lëndime gjatë punës.
- e.* zgjidhja e problemit të ushqimit, pushimit, rekreacionit dhe nevojave tjera të punës dhe jetës së punëtorëve, me qëllim të kushteve të sigurta në punë
- f.* sigurimin e mjeteve për kryerjen e detyrave të planifikuara.

### **Neni 33**

33.1 Programi i masave të mbrojtjes në punë, përcakton obligimet dhe detyrat nga Plani i

mbrojtjes në punë të cilat duhet kryer në periudhën për të cilën programi aprovohet, afatin, mënyrat e kryerjes së obligimeve dhe detyrat si dhe cakton organet dhe punëtorët që janë përgjegjës për realizimin e tij.

#### Neni 34

34.1 Programi i masave të sigurisë në punë përmbanë:

- a. procedurën, mënyrën dhe afatin e evitimit të të metave në lëmin e mbrojtjes në punë, posaqërisht të atyre që i ka theksuar inspektori i punës kompetent.
- b. dinamikën dhe afatet e kontrollimeve mjekësore të punëtorëve
- c. dinamikën e kontrollimit të ambientit të punës, posaqërisht për vendet e punës me kushte të posaçme të punës duke caktuar kryerësin e kësaj pune (qoftë nga punëtorët e Kompanisë apo nga entet e autorizuar).
- d. dinamikën e aftësisimit të punëtorëve nga lëmi i sigurisë në punë si dhe orarin e vërtetimit të njohurive nga kjo materie
- e. burimet e mjeteve financiare për zbatimin e masave të mbrojtjes në punë
- f. Aftësimi i punëtorëve për mbrojtje në punë dhe njohja e tyre me kushtet e punës dhe burimet e rrezikut.

34.2 Para caktimit në vendin e punës, punëtori duhet të njoftohet me :

- a. Procesin teknologjik të punës në tërësi, posaqërisht me organizimin e punës dhe mënyrën më të drejtë të punës (ardhjen në vendin e punës lëvizjen në vendin e punës dhe ambientin e punës, mënyrën e kryerjes së punës ) etj.
- b. Dispozitat e përgjithëshme dhe të posaqme , masat dhe udhëzimet e mbrojtjes në punë si dhe me obligimin që në punë duhet të iu përmbahet atyre si dhe me pasojat që rrjedhin nga mospërmbajtja e masave të mbrojtjes në punë.
- c. Mjetet personale dhe kolektive të mbrojtjes, pajisjet dhe veglat për mbrojtje në punë që është i obliguar t'i shfrytëzojë në vendin e punës, mënyrën e përdorimit të tyre dhe shfrytëzimin e tyre të dedikuar.
- d. Të drejtat dhe obligimet nga lëmia e mbrojtjes në punë.
- e. Masat tjera që mund të jenë të rëndësishme për mbrojtje në punë.

34.3 Punëdhënësi është i obliguar që të kujdeset për aftësimin e punëtorëve nga lëmi i mbrojtjes në punë, posaqërisht :

- a. Në rast të ndërrimit të procesit teknologjik ;
- b. Shfrytëzimit të mjeteve dhe pajisjeve të reja të punës ;
- c. Ndërrimit të organizimit të punës ;
- d. Kryerjes së rekonstruktiveve, adaptimeve, etj.
- e. Ndërrimit të kushteve të punës ;
- f. Caktimit të dispozitave të reja të mbrojtjes në punë ose të ndërrimit apo plotësimit të tyre, e që kanë të bëjnë me punën e punëtorit në vend të caktuar të punës

#### Neni 35

##### Programi i aftësisimit

35.1 Programi i aftësisimit të punëtorëve nga lëmi i sigurisë në punë përcaktohet në bazë të nevojave të Kompanisë. Programet e tilla duhet të jenë në harmoni me punët që punëtorët duhet t'i kryejnë në sektorët dhe njësitë e caktuara punuese.

35.2 Aftësimi i punëtorëve për mbrojtje në punë përbëhet nga pjesa teorike dhe praktike . Aftësimi mund të bëhet për të gjitha kategoritë e punëtorëve të Kompanisë.

## Neni 36

36.1 Pjesa teorike e programit të aftësisimit nga lëmia e sigurisë në punë, varësisht nga vendi i punës dhe burimi i rrezikut mund të përmbajë :

- a) Fazat e mbrojtjes në punë dhe shkaqet për të cilat zbatohet ;
- b) Rreziqeve të cilave u nënshtrohet punëtori gjatë kryerjes së punës dhe mënyra e mbrojtjes
- c) Udhëzimet për shfrytëzimin e drejtë të mjeteve personale të mbrojtjes dhe mjeteve ndihmëse teknike në vendin e punës.
- d) Mënyra e ofrimit të vet-ndihmës dhe ndihmës së parë
- e) Shpëtimi I punëtorëve në rast të fatkeqësive elementare dhe mënyra e evakuimit në rast të zjarrit, eksplozimeve apo dukurive tjera që mund të rrezikojnë numër më të madh të punëtorëve
- f) Të drejtat e punëtorëve dhe obligimet e tyre lidhur me mbrojtjen në punë dhe mënyra e realizimit të atyre të drejtave, si dhe
- g) Pasojat në rast të shkeljeve të dispozitave nga siguria në punë.

36.2 Programin e aftësisimit, plotësimet dhe ndryshimet e tij i bënë Zyrtari i mbrojtjes në punë ndërsa e aprovon Bordi i Drejtorëve.

36.3 Në hartimin dhe zbatimin e programit të aftësisimit të punëtorëve, sipas nevojës, mund të aftësohen edhe shërbime dhe bashkëpunëtor të jashtëm profesional.

## Neni 37

### Procedura e aftësisimit

37.1 Me rastin e aftësisimit teorik të punëtorëve ata në mënyrë të përshtatshme njoftohen me materien e mbrojtjes në punë, e cila është e paraparë për ata.

37.2 Aftësimi praktikë zbatohet kur vlerësohet se në aspektin teorik është informuar me materien e mbrojtjes në punë.

37.3 Në rastet kur udhëheqësi i drejtëpërdrejtë bënë vetë aftësimin e punëtorëve, zgjidhen metodat më të mira të aftësisimit praktikë të punëtorëve në vendin e punës, duke u nisur nga ndërlíkueshmëria dhe natyra e punës

## Neni 38

### Vërtetimi i njohurive

38.1 Punëdhënësi është i obliguar që vërtetimin e aftësisimit të punëtorëve për punë të pavarur dhe të sigurtë t'a bëjë në harmoni me Ligjin Nr.04/L- 161 për sigurinë dhe shëndetin në punë ashtu që vërtetimi të zgjerohet dhe në aplikimin praktik të masave të parapara për siguri në punë si dhe vërtetimi i pjesës teorike të përfshijë të gjitha çështjet e rëndësishme e të nevojshme për kryerjen e pavarur dhe të sigurt të punëve të besuara.

38.2 Pas vërtetimit të njohurive teorike për mbrojtje në punë, udhëheqësi i drejtëpërdrejtë ose punëtori të cilin ai e autorizon, bënë vërtetimin e aftësisimit të punëtorëve për punë të pavarur në aspektin praktikë drejtëpërdrejtë në vendin e punës në të cilin punëtori duhet të punojë.

38.3 Vërtetimi në punën praktike bëhet ashtu që punëtori i caktuar në punën e vet praktike tregon se është në gjendje t'i kryejë të gjitha operacionet teknologjike në mënyrë të sigurt dhe të pavarur.

38.4 Puna praktike zbatohet në të gjitha njësit punuese si dhe për punët që punëtori do t'i kryejë në punën e përditëshme.

38.5 Punëtori I cili sipas vlerësimit nuk tregon aftësim të mjaftueshëm, duhet sërish t'i nënshtrohet aftësimit . Në rast se edhe pastaj nuk tregon se është aftësuar do të vendoset në bazë të dispozitave të akteve tjera të përgjithëshme se në cilin vend pune do të caktohet punëtori I tillë.

#### **Neni 39**

##### **Njohja e punëtorëve me rreziqet në vendin e punës**

39.1 Para caktimit në punë tjera, respektivisht në vend të ri të punës, punëtori duhet të informohet me të gjitha burimet e rrezikut në punë, posaqërisht me rreziqet për jetë dhe shëndet që mund të paraqiten gjatë kryerjes së punës në atë vend, si me shfrytëzimin e mjeteve të rrezikshme për punë dhe të pajisjeve ashtu edhe me shfrytëzimin e materialeve.

39.2 Me burimet e rrezikut në vendin e punës, punëtori njoftohet gjatë aftësimit nga lëmi i mbrojtjes dhe sigurisë në punë.

39.3 Para caktimit të punëtorit në punë të re, personi përgjegjës vërteton njohurin e punëtorit për rreziqet lidhur me atë vend pune dhe aty për aty i shpjegon dhe njofton me burimet e rrezikut duke ia paraqitur ato në mënyrë të përshtatshme, si dhe e informon me pasojat eventuale për shëndetin në rast se nuk është i kujdesshëm në punë respektivisht në rast se nuk i shfrytëzon pajisjet dhe mjetet për mbrojtje personale.

39.4 Nëqoftëse udhëheqësi i drejtpërdrejt vlerëson që punëtori i cili është caktuar në vend pune me kushte të posaçme nuk është sa duhet i kujdesshëm për kryerjen e atyre punëve, ku për këtë arsye i kanoset rreziku nga lëndimet në punë, do t'i propozojë udhëheqësit të njësisë që punëtori i tillë të caktohet në punë tjera.

40.5 Udhëheqësi i drejtpërdrejtë është i obliguar që me vëmendje të posaçme të përcjell punën e punëtorëve të ri në vendet e punës me kushte të posaçme dhe atë t'a vizitojnë më shpesh gjatë punës dhe sipas nevojës t'i përsërisë vërejtjet për burimet e mundshme të rrezikut në punë.

#### **Neni 40**

##### **Punët me kushte të veçanta**

40.1 Punë me kushte të veçanta sipas dispozitave ligjore janë punët që mund të kryhen vetëm nga të punësuarit të cilët përveç kushteve të përgjithshme për themelimin e marrëdhënies së punës, duhet të përmbushin edhe kushtet dhe kriteret e veçanta të moshës, gjinisë, aftësisë profesionale, shëndetësore, fizike, gjendjes mendore, psiko-fizike dhe psikologjike.

40.2 Punëdhënësi nuk duhet të caktoj të punësuarin në punë me kushte të veçanta, në qoftë se paraprakisht, në mënyrë të shkruar, nuk është përcaktuar që i punësuari i plotëson kushtet dhe kriteret e nevojshme nga paragrafi 1. i këtij neni.

40.3 Punëdhënësi është i detyruar që para se ta caktoj të punësuarin në vend të punës me kushte të veçanta, t'a dërgoj atë në kontroll mjekësor, që të konstatoj aftësitë e tij shëndetësore, fizike dhe psikike, për kryerjen e punëve në atë vend të punës.

40.4 Punëdhënësi është i detyruar të ofroj dëshmi me shkrim në përshkrimin e punëve dhe detyrave të punës për të punësuarin në vend të punës me kushte të veçanta, se ai i plotëson kushtet dhe kriteret për punë në vend të punës me kushte të veçanta në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni.

40.5. Punëdhënësi të punësuarin i cili punon në vend të punës me kushte të veçanta të punës, është i detyruar t'a dërgoj në kontrollim mjekësorë së paku një herë në vit dhe sa herë të paraqitet nevoja, varësisht prej gjendjes shëndetësore të tij.

#### **Neni 41**

##### **Kontrollimet periodike dhe shqyrtimi i mjeteve të punës**

41.1 Në afatet e parapara me Ligj do të bëhet kontrolli i mjeteve dhe pajisjeve të punës.

41.2 Mirëmbajtjen e mjeteve të punës, pajisjeve dhe mjeteve prodhuese, mund t'a bëjnë vetëm personat e caktuar dhe profesionalisht të aftësuar.

41.3 Mjetet e punës, pajisjet dhe mjetet prodhuese, para përdorimit respektivisht lëshuarjes në funksion, duhet të kontrollohen nga personat që i mirëmbajnë.

#### **Neni 42**

##### **Mbrojtja e përgjithshme në punë**

42.1 I punësuar ka të drejtë për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit dhe në ambientin e përshtatshëm të punës, në përputhje me Ligjin e punës, Ligjin për siguri dhe shëndet në punë dhe aktet të brendshme.

42.2 Punëdhënësi është i detyruar :

- a) të siguroj kushtet e nevojshme për siguri në punë, me të cilat sigurohet mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të të punësuarve
- b) t'a informoj punëtorin me shkrim para angazhimit të tij, për rreziqet në punë dhe për masat mbrojtëse të cilat obligohet t'i zbattoj.
- c) të japë udhëzime që tregojnë rreziqet në punë dhe masat mbrojtëse të cilat duhet të merren në përputhje me udhëzimet e lëshuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- d) t'i zbatoj rregullat dhe procedurat e përgjithshme për sigurin dhe shëndetin në punë, që janë të përcaktuara me Ligjin për Sigurin dhe shëndetin në punë.
- e) t'i përmbahet rregullave për sigurin dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, në mënyrë që mos të rrezikoj shëndetin dhe sigurin e vet, si dhe sigurin dhe shëndetin e punëtorëve të tjerë.

#### **Neni 43**

##### **Mbrojtja e të rinjve, femrave dhe e personave me aftësi të kufizuara**

43.1 Femra e punësuar, i punësuar nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe personi me aftësi të kufizuara, gëzojnë mbrojtje të veçantë në përputhje me Ligjin e Punës dhe me këtë Rregullore..

#### **Neni 44**

##### **Caktimi i të punësuarit në punët që janë me rrezik të shtuar**

44.1 I Punësuar nuk mund të caktohet që të punoj më gjatë se orari i plotë i punës apo në punë nate, nëse në bazë të konstatimit të organit kompetent për vlerësimin e gjendjes shëndetësore, një punë e tillë mund ta përkeqësoj gjendjen e tij shëndetësore.

44.2 Në punët dhe detyrat e punës në të cilat ekziston rreziku i shtuar i lëndimit, sëmundjes profesionale ose i sëmundjeve tjera, mund të caktohet i punësuar, i cili i plotëson kushtet e veçanta për punë, në bazë të:

- (a) aftësive shëndetësore;
- (b) kualifikimit profesional;
- (c) përvojës së fituar në punë; dhe
- (d) moshes

## Neni 45

### Mbrojtja e te rinjve

45.1 I punësuari nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç nuk mund të punoj në punët të cilat për nga natyra apo rrethanat nën të cilat kryhen, mund të dëmtojnë shëndetin apo sigurinë e tij.

45.2 Punëdhënësi është i obliguar që:

- a) të adaptoj masat e nevojshme për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të të rinjve, duke specifikuar rreziqet në procesin e punës.
- b) t'i zbatoj masat e përcaktuara për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit, në bazë të vlerësimit të rrezikshmërisë për vendet e punës së të rinjve.
- c) ta bëjë vlerësimin paraprak të rrezikshmërisë për vende të punës, para se i riu t'ia filloj punës.

45.3 I punësuari nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç nuk mund të punoj në punët e rrezikshme, si në vijim:

- a) në nëntokë, nën ujë, në lartësi të rrezikshme apo në vende të mbyllura,
- b) me makineri të rrezikshme, në pajisjet dhe veglat, të cilat duhen shfrytëzuar dhe në transportimin e ngarkesave të rënda;
- c) në mjedis jo të shëndoshë, i cili për shembull i ekspozon të rinjtë në substancat e rrezikshme, faktorëve ose proceseve, temperaturave, zhurmave dhe dridhjeve që dëmtojnë shëndetin e tyre;
- d) nën kushte posaçërisht të vështira siç është puna me orar të gjatë, apo në rrethana të caktuara gjatë natës, puna në mjedis të mbyllur.

## Neni 46

### Mbrojtja e femrave të punësuar

46.1 Femrës shtatzënë dhe mëndeshë i ndalohet të bëj punë e cila është e përcaktuar si e dëmshme për shëndetin e nënës apo të fëmijës.

46.2 Femrës shtatzënë dhe mëndeshë i ndalohet të punoj në vendet e punës ku paraqiten punë veçanërisht të rënda fizike, punë që i ekspozohen faktorëve biologjik, kimik apo fizikë të cilët paraqesin rrezik për shëndetin.

## Neni 47

### Mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara

47.1 I Punësuari tek i cili paraqitet aftësia e kufizuar, ka të drejtë të punoj në punën e tij ose punë tjera përkatëse, nëse sipas aftësisë së mbetur për punë mund ta kryej atë punë pa rehabilitim profesional.

47.2 I Punësuari të cilit i është zvogëluar aftësia shëndetësore për punë dhe pas rehabilitimit profesional është aftësuar të kryej punë të caktuara, konsiderohet i aftë për kryerjen e atyre punëve.

47.3 Në rastet si në paragrafin 2 të këtij neni, Punëdhënësi ka për detyrë që të punësuarit t'ia siguroj atë lloj pune për të cilën është aftësuar pas rehabilitimit profesional.

47.4 Në qoftë se i Punësuari refuzon t'i pranoj punët sipas këtij neni, punëdhënësi me paralajmërim mund t'ia shkëputë kontratën e punës.

## Neni 48

### Mbrojtja e amësisë

48.1 Femra e punësuar gjatë kohës së shtatzënisë, nëna me fëmijë nën moshën tri (3) vjeç, nuk

mund të obligohet të punoj më gjatë se orari i rregullt i punës, dhe në punë gjatë natës.



48.2 Prindi vetushqyes, me fëmijë të moshës deri tri (3) vjeç dhe me fëmijë me invaliditet të rëndë, nuk mund të detyrohet të punoj më gjatë se orari i rregullt i punës dhe punë gjatë natës.

48.3 Të drejtat nga paragrafi 1. i këtij neni, mund t'i shfrytëzoj edhe adoptuesi i fëmijës, përkatësisht personi tjetër që kujdeset për fëmijën, në rast të vdekjes së dy prindërve të fëmijës, ose nëse prindi e braktis atë.

#### **Neni 49**

##### **Njoftimi për aksidentet në punë**

49.1 Në rastet kur ka ndodh aksidenti me pasojë lëndimin apo vdekjen e të punësuarit, punëdhënësi është i detyruar t'a lajmërojë menjëherë inspektorin e punës .

49.2 Aksidenti vlerësohet se ka ndodhur në punë ose lidhur me punën kur i punësuari lëndohet gjat :

- a) kryerjes së punës në subjektin punues ku është punësuar
- b) kryerjes së një pune tjetër pa ose me urdhër të punëdhënësit, për arsye madhore, në interes të punës
- c) kohës së pushimit të përcaktuar nga punëdhënësi, vënien në rregullë të makinerive, veglave të punës, veshmbathjeve, pastrimit të vendit të punës para ose pas mbarimit të punës
- d) kohës së aftësisimit profesional
- e) dhënjes së ndihmës së pare lidhur me punën

49.3. Bazuar në pasojat, aksidentet në punë mund të jenë :

- a. Aksidente të cilat shkaktojnë paafësi të përkohëshme në punë
- b. Aksidente të cilat shkaktojnë paafësi të përherëshme në punë
- c. Aksidente me pasojë vdekjen në punë

49.4. Bazuar në numrin e personave të lënduar në punë aksidentet mund të jenë:

- a) Aksidentet individuale - kur lëndim në punë pëson vetëm një person
- b) Aksidentet massive - ku të paktën dy apo më shumë të punësuar lëndohen në të njëjtën kohë dhe për shkak të arsyeve të njëjta.

#### **Neni 50**

50.1 Në vendin ku ndodh lëndimi ose fatkeqësia, nuk guxon të ndërrohet asgjë, derisa të bëhet shikimi i vendit të ngjarjes, i cili përfshinë:

- a) Shikimi i vendit të ngjarjes
- b) Marrja në pyetje e të lënduarit, dëshmitarëve okular dhe udhëheqësit të drejtpërdrejtë
- c) Kontrollimi i mjeteve dhe pajisjeve të punës
- d) Kontrollimi i pajisjeve mbrojtëse
- e) Kontrollimi i mjeteve dhe pajisjeve personale të mbrojtjes
- f) Shikimi i rrethanave tjera të rëndësishme për zbulimin e shkakut të lëndimit të punëtorit.

50.2 Për çdo shikim në vendin e ngjarjes mbahet procesverbal, në të cilin duhet të konstatohet burimi dhe shkaku i lëndimit dhe eventualisht me fajin e kujt ka ndodhur lëndimi.

50.3 Me shikimin në vend ngjarje udhëheq Zyrtari për siguri dhe shëndet në punë.

50.4 Në vendin e punës ku ekziston rreziku i lëndimit ose ka ndodhur lëndimi, nuk mund të lejohet vazhdimi i punës, përderisa shërbimi kompetent nuk konstaton se janë evituar burimet e rrezikut, respektivisht shkaqet për shkak të të cilave ka mund apo ka ndodh lëndimi.

50.5 Zyrtari për siguri dhe shëndet në punë është i obliguar, që në harmoni me afatet e caktuara, të përgatit dhe përpunoj profesionalisht:

- a. Raportet lidhur me konstatimet e Inspektoriatit të punës dhe evitimin e të metave të caktuara, si dhe përmirësimin e masave të sigurisë në punë për të cilat janë dhënë vendime, procesverbale ose konstatime të posaçme gjatë kontrollimit të gjendjes të mbrojtjes në punë në Kompani
- b. Raportin për vdekjen, lëndimin kolektiv apo trupor në punë, si dhe për dukuritë që do të mund të rrezikojnë sigurinë e punëtorëve
- c. Raportet lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë ose të dhëna tjera, nëse i kërkon Inspektorati i punës
- d. Raportet tjera, shënimet dhe urdhëresat tjera në harmoni me këtë Rregullore dhe Ligjin, si dhe të gjitha paraqitjet dhe evidencat për lëndimet në punë dhe sëmundjet lidhur me punën, si dhe evidencat për aftësimin e punëtorëve.

50.6 Organi kompetent i Inspektoratit të punës, duhet të informohet me kohë për çdo rast vdekje, fatkeqësi kolektive në punë, lëndim të rëndë në punë, si dhe për çdo dukuri që do të mund të rrezikonte sigurinë e punëtorëve.

50.7 Informimin sipas rregullit e bën Zyrtari për siguri dhe shëndet në punë, nëse kjo nuk është e mundur, atëherë këtë do ta bëjë drejtpërsëdrejti punëtori përgjegjës.

#### Neni 51

##### **Blerja dhe mirëmbajtja e mjeteve të mbrojtjes personale**

51.1 Të gjitha mjetet për sigurinë në punë që i shfrytëzojnë punëtorët duhet t'iu përgjigjen dispozitave dhe standardeve të sigurisë në punë.

51.2 Urdhëresën për blerjen e mjeteve për sigurinë dhe shëndetin në punë e lëshon udhëheqësi i drejtëpërdrejtë, ndërsa e nënshkruan dhe e lejon Kryeshefi Ekzekutiv ose personi tjetër i autorizuar në Kompani.

51.3 Mirëmbajtjen e mjeteve dhe pajisjeve personale për sigurinë dhe shëndetin në punë e bëjnë personalisht punëtorët që janë të ngarkuar me ato mjete dhe pajisje.

51.4 Në rast se para kalimit të afatit të qëndrueshmërisë dëmtohen mjetet personale dhe pajisjet për sigurinë dhe shëndetin në punë, sa që të njëjtat nuk mund të shfrytëzohen me efikasitet, punëtorit edhe para kalimit të afatit të qëndrueshmërisë i jepet mjete i ri.

#### Neni 52

##### **Hyrja në fuqi**

52.1 Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e aprovimit të të njëjtës nga Bordi i Drejtorëve të KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë.

Kryesues i Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve  
Mr. Sci. Bajram Mustafa

